



KOLEGJI  
UNIVERSITAR  
QIRIAZI

## SENATI AKADEMIK

---

# RREGULLORE E KESHILLIT TE ETIKES

TIRANË, 2017



## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Baza ligjore**

Rregullorja e Këshillit të Etikës së Kolegjit Universitar “Qiriazhi”, është mbështetur në ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në Statutin e këtij Kolegji, në vendimet e Senatit Akademik si dhe në Rregulloren e Kolegjit.

### **Neni 2 Objekti i Rregullores**

Objekti i Rregullores së Këshillit të Etikës është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Këshillit ,përcaktimi i të drejtave dhe detyrave të anëtarëve të tij, si dhe procedurës që do të ndiqet për trajtimin e shkeljeve të këtyre rregullave dhe i masava ndëshkuese që mund të merren në raste të ndryshme.

### **Neni 3 Parimet Bazë**

Kolegji Universitar “Qiriazhi”. është një institucion i arsimit të lartë, anëtarët e të cilit(staf akademik, administrativ dhe studentë), kanë formime të ndryshme, mbulojnë role dhe përgjegjësi të larmishme.

Ekzistenca e një komuniteti kërkon, si njohjen dhe respektimin e të drejtave individuale, po ashtu dhe pranimin e detyrave dhe përgjegjësi kundrejt institucionit universitar, nga të gjithë anëtarët dhe bashkësia.

Kolegji u kërkon pedagogëve, personelit administrativ dhe studentëve, si dhe çdo anëtari tjetër të institucionit, përmbushjen e detyrave respektive në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e marra përsipër, si individualisht, ashtu dhe në kuadrin e organeve kolegjiale, të respektojnë, mbrojnë dhe përkrahin vlerat themelore të institucioneve universitare, mes të cilave:

- a. dinjitetin njerëzor;
- b. mospranimin e asnjë lloj diskriminimi të padrejtë dhe vlerësimin si të meritës, ashtu dhe të ndryshueshmërive individuale dhe kulturore;
- c. respektimin e lirisë dhe të drejtave themelore;
- d. përgjegjësi dhe njohje e përmbushje të detyrave kundrejt komunitetit;
- e. ndershmëri dhe profesionalitet;
- f. njohje, përsosmëri dhe inkurajim të studimeve dhe kërkimeve shkencore;
- g. drejtësi, paanësi, bashkëpunim dhe transparencë.

Vlerat e përcaktuara në këtë nen kërkojnë standarde sjelljeje të rëndësishme për veprimtarinë dhe jetën e Kolegjit.



